

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ASA Center” Sh.p.k.**

Sot më datë 30.08.2025, u paraqit pala e mëposhtme:

- **Z. Olger Rakiplari**, atësia Petro, qytetar shqipëtar, lindur më 09 Maj 1992, në Korçë, banues në Tiranë, Rruga “Bego Hoxha”, Misto Mame, mbajtës i dokumentit të identifikimit (ID), me nr. Personal J20509070F;

me cilësinë e Ortakut të vetëm themelues, ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë “Shoqëria”), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti së cilës i bashkangjitet (më poshtë “Shtojca 1).

Neni 1 – Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është “ASA Center” Sh.p.k.

Neni 2 - Selia

Selia e Shoqërisë është në Rruga “3 Dëshmorët” Grand Gallery, Hyrja D, Kati 1, Tiranë, Shqipëri.

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë do të jetë me një afat të pacaktuar.

Neni 4 – Objekti i shoqërisë

4.1 Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

4.2 Në mënyrë më specifike, Shoqëria do të mund të kryejë:

Organizimin dhe zhvillimin e kurseve të formimit profesional dhe artistik, në veçanti kurse të artit figurativ (pikturë, grafik shtypi, skulpturë, stilim, dizajn mode), dizajn grafik, arkitekturë;
Organizimin e ekspozitave, aktiviteteve kulturore dhe artistike, si dhe promovimin dhe shitjen e veprave të artit (piktura, skulptura, objekte arti e koleksioni);
Administrimin dhe zhvillimin e galerive të artit dhe hapësirave ekspozuese;
Projektim grafik, dizajn, botime, gazetari, përgatitje dhe shpërndarje fletëpalosjesh, materiale promocionale, si dhe organizim eventesh;
Tregtimin me shumicë dhe pakicë të materialeve të artit, kancelarisë, librave, revistave, materialeve didaktike dhe pajisjeve për art e dizajn.

4.3 Shoqëria mund të kryejë kërkime të tregut, organizojë rrjete tregtare, nënshkruajë kontrata agjencie, të marri dhe të japi agjenci, komisione, përfaqësime dhe mandate. Shoqëria mund të kryejë për shoqëritë me kuota në pjesëmarrje dhe të lidhura shërbime tekniko – administrative dhe koordinimi, shërbime promovimi dhe marketingu dhe çdo aktivitet për zgjidhjen e problemeve në fushën administrative.

4.4 Së fundi, Shoqëria mund të kryejë çdo operacion tregtar, operacione që lidhen me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme dhe hipotekore që lidhen me to, operacione financiare dhe kredimarrje, të japë garanci të tretëve si edhe të blejë dhe shesë ose marrë me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si edhe të ketë pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsociume, të themeluara apo në themelim e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin apo gjithsesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë. Më në përgjithësi, Shoqëria mund të kryej çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve të shoqërisë.

Neni 5 – Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 10.000 (dhjetëmijë) lekë.

5.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuota, të gjitha të nënshkruara dhe për tu shlyer me vlerë kapitali 10.000 lekë.

Neni 6 - Kontributet

6.1. Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:

- **Z. Olger Rakiplari** qytetar shqiptar, lindur më 09 Maj 1992, në Korçë, banues në Tiranë, Rruga “Bego Hoxha”, Misto Mame, mbajtës i dokumentit të identifikimit (ID), me nr. Personal J20509070F ka ofruar një kontribut në para të barabartë 10.000 (dhjetëmijë) lekë, në favor të shoqërisë në themelim e sipër.

6.2. Sipas kontributeve të mësipërme:

- **Z. Olger Rakiplari**, i përket 1 (një) kuotë, që i korrespondojnë 100% (njëqindpërqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 7 – Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 – Administrimi

8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administratorë i Shoqërisë personi si më poshtë:

- **Z. Olger Rakiplari** qytetar shqiptar, lindur më 09 Maj 1992, në Korçë, banues në Tiranë, Rruga “Bego Hoxha”, Misto Mame, mbajtës i dokumentit të identifikimit (ID), me nr. Personal J20509070F.

- 8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 Prill 2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” dhe nenit 14 të Statutit.
- 8.3 Administratorëve u jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të formalitetet e përmbushjen e detyrimeve të parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratorët, mund t'u drejtohen për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.
- 8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tyre personave të tjerë.

Neni 9– Gjuha

- 9.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

* * *

ORTAKU I VETËM

Z. Olger Rakiplari

